



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:211865

Datë: 17.10.2019

Numri i dokumentit: 00584084

P.nr.1014/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale e përbërë nga gjyqtari i vetëm gjykues Ilir Bytyqi, me asistentin Muedin Rexhepi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.V nga Ferizaj, për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së, si dhe veprës penale të kanosjes nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1556-7/19 të dt.25.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Albana Parduzi, të dëmtuarave M.V dhe XH.V, si dhe të akuzuarit R.V me avokatin mbrojtës A.I, me datën 27.09.2019 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 11.10.2019, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: R.V i lindur me dt..... në Ferizaj, me vendbanim në Rr. ... nr. .. në Ferizaj, nga i ati E... dhe nëna N.... e vajzërisë J..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, prind i pesë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, posedon dokument identifikimi ..., në paraburgim nga data 30.08.2019 deri me datën 27.09.2019.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

1. Me 27 Gusht 2019, rreth orës 19;00, në rrugën ... në Ferizaj, përkatish në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri ka shkaktuar dhunë në familje, në atë mënyrë që me dashje ka përdorë forcën ndaj të dëmtuarës-bashkëshortes së tij XH.V, duke e goditur fillimisht me këmbë në trup e më pas e gjuan dhe e përplas për toke si dhe e tërheqë zvarrë deri tek dera e dhomës së ndejes, deri ndërhyjnë vajza e tyre M.... e cila arrin që ta evitojë më të keqen.

me këtë ka kryer veprën penale të sulmit nga neni 184 par. 3 nënpar. 3.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së

2. Me 29 Gusht 2019, në mbrëmje, në Ferizaj, në rrugën përkatësisht në shtëpinë e tyre, i pandehuri a shkaktuar dhunë në familje, në atë mënyrë që si pasojë e rastit të ndodhur një natë më parë, ku i njëjti kishte sulmuar fizikisht bashkëshorten e tij Xh....., me të kuptuar se tani e dëmtuara vajza e tij M.V ishte ftuar nga ana e prokurorisë për tu intervistuar në cilësi të dëshmitares, i njëjti me qëllim të frikësimit apo shkaktimit të ankthit, ka kanosur seriozisht, me fjalë të njëjtën duke i thënë “se nëse ti flet atje, kam me ta këput kryet si vremqit”, me çrast tek e dëmtuara me veprimet e tij ka shkaktuar frikë dhe pasiguri.

me këtë ka kryer veprën penale të kanosjes nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve të sipërcekura dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42 të KPRK-së si dhe 365, 370, 453, 463, të KPPK-së të akuzuarit i

CAKTON DËNIM

- Për pikën një të dispozitivit, për veprën penale të sulmit nga neni 184 par. 3 nënpar. 3.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) Muaj.
- Për pikën dy të dispozitivit, për veprën penale kanosje nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) Muaj.

Gjykata konform dispozitës ligjore të nenit 76 të KPRK-se, të akuzuarin R.V, e gjykon

DENIM UNIK ME BURG

- Në kohëzgjatje prej 5 (pesë) Muaj, të cilin dënim do ta vuaj menjëherë pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.
- Në dënimin e shqiptuar si më lartë i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 30.08.2019 deri me datën 27.09.2019
- Të dëmtuarat: M.V dhe XH.V, me vendbanim në ..., nr... në Ferizaj, kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore-juridike.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej 30 Euro (tridhjetë), brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP.II.nr.1556-7/19 të datës 25.09.2019 ka ngarkuar të akuzuarin R.V për veprat penale sulmi nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me nenin 248 par.2 të KPRK-së dhe veprën penale kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me nenin 248 par.2 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj, pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e sajë dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po ashtu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën ngarkohet i akuzuari gjykohet nga gjyqtar i vetëm gjykues.

Gjykata Themelore në Ferizaj, në duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar me datë 27.09.2019, në të cilin shqyrtim të pranishëm ishin prokurorja e shtetit Albana Parduzi, të dëtmuarat M.V dhe XH.V, si dhe i akuzuari R.V dhe mbrojtësi i tij me autorizim av. A.I.

Në fillim të shqyrtimit fillestar në mbështetje të nenit 245 par.2 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari në mënyrë të rregullt ka pranuar kopjen e aktakuzës nga ana e Prokurorisë Themelore në Ferizaj si dhe ka konstatuar se janë plotësuar detyrimet lidhur me zbulimin e provave të parapara ë nenin 245 par.4 të KPPK-së.

Deklarimet e palëve dhe provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi gjykata ka udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPK-së, dhe pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar ne tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, në pajtim me nenin 346 par.3 të KPPK-së, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit te shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar ne tërësi aktakuzën, konform nenit 246 par.4 të KPPK-se, i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari R.V me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e pranon fajësinë për penale sulmi nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së, si dhe veprën penale kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas të gjitha pikave të aktakuzës, fajin e pranon vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, është i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë duke shtuar se i vjen keq për këtë vepër penale, ndihet thellë i penduar, kërkon falje publike bashkëshortes dhe vajzës së tij duke premtuar se veprime të tilla apo të ngjashme nuk do të përsëri.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues duke vepruar në pajtim me nenin 248 par.2 të KPPK-së, ka kërkuar edhe mendimin e prokurores së shtetit.

Prokurorja e shtetit Albana Parduzi duke shprehur mendimin e saj lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, meqë ky pranim është i bazuar në gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, pranimin e fajësisë i akuzuari e ka bërë vullnetarisht dhe se një pranim i tillë është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 të KPPK-se si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

E dëmtuara M.V në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe nuk ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike duke theksuar se prindi i sajë tani ka pranuar gabimin e bërë dhe beson se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla apo të ngjashme e në rast se i njëjti prapë përsërit do ta njoftojnë policinë dhe prokurorinë.

E dëmtuara XH.V në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe nuk ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike duke theksuar se raportet në familjen e tyre janë herë pas here të këqija, nuk është hera e parë që bashkëshorti i sajë ka përdorur dhunën ndaj sajë dhe se atë që e thotë bashkëshorti i sajë ata duhet ta zbatojnë duke mos i lënë as të flasin.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av. A.I në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se mbështet në tërësi pran deklarimeve të klientit të tij lidhur me pranimin e fajësisë për veprat penale që i vihet në barrë, duke qenë se me klientin e tij kanë shqyrtuar të gjitha rrethanat dhe faktet e

ngjarjeve kritike, ai është i vetëdijshëm dhe me vullnet të plotë ka vendosur ta pranoj fajësinë si dhe një pendim shumë të thellë dhe real për veprimet të cilat i ka manifestuar në familjen e tij, njëkohësisht duke u zotuar që në të ardhmen në asnjë rast dhe në asnjë mënyrë nuk do të përsëris veprime të tillë. Me rastin e caktimit dhe lartësisë së dënimit i propozon gjykatës ti merr parasysh rrethanat lehtësuese se ka bërë pranimin e fajësisë, sinqeritetin dhe korrektësinë në të gjitha fazat e procedurës penale, është person i pa gjykuar deri më tani, në ndërkohë ka kërkuar falje të dëmtuarave, tani i ka përmirësuar marrëdhëniet.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av. A.I, konsideron se në rastin konkret cilësimi juridik për të dy pikat e aktakuzës, respektivisht par. 4 dhe par. 3 i neneve respektive nuk qëndron sepse në rastin konkret as në përshkrimin faktik nuk është përcaktuar se kemi të bëjmë me person të ndjeshëm e që është kusht për ekzistimin e kësaj vepre. Por nëse i referohemi nenin 113 pika 39 të KPRK-së, në mënyrë taksative është përcaktuar kush cilësohet person i ndjeshëm, andaj i propozon gjykatës të mos e pranon cilësimin juridik të prokurorisë dhe në bazë të nenin 630 par. 1 të KPPK-së, të cilësoj sipas përshkrimit faktik par. 1 të nenit 184 të KPRK-së, dhe nenit 1 (eventualisht par. 2) të nenin 181 të KPRK-së.

Provat e paraqitura në shqyrtimin fillestar dhe të gjeturat e gjykatës

Meqë i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së pasi i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresën e lëndës siç janë: deklarata e të dëmtuarës XH.V e datës 05.09.2019, deklarata e të dëmtuarës M.V e datës 30.08.2019, deklarata e dëshmitarit A.V e datës 05.09.2019, raporti i oficerit i datës 28.08.2019, raporti mbi ekspertizën prikiatrike për gjendjen e shëndetit mendor të të akuzuarit R.V të punuar nga IPFK me datën 24.09.2019, si dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e parashikuar më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin*

fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mundë të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të datës 19.03.2013).

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale sulmi nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe veprës penale kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes në pikën I dhe pikën II të dispozitivit.

Vlerësimi lidhur me kualifikimi ligjorë të përshkruar në të dy dispozitivat e aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues e ka pranuar sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se: për pikën I-rë, neni 184 par. 3 nënpar. 3.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe për pikën II-të, neni 181 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së, qëndron e bazuar sepse të dëmtuarat janë në bashkësi të ngushtë familjare, në ekonomi të përbashkët familjare, ndajnë një ambient të përbashkët banimi, andaj çdo formë e dhunës fizike, psikike, ekonomike, seksuale ndaj këtyre kategorive e bënë të ndjeshëm viktimën. Në rastin konkret veprimet e dhunës ka sjellë si pasojë cënimin e integritetit fizik të e dëmtuara XH.V, ndërsa të e dëmtuara M.V pasoja ka sjellë cënimin e integritetit psikosocial siç është shkaktimi i ankthit, rrethanë kjo cilësuese e veprat penale.

Ndërsa pjesën tjetër të rikualifikimit nga ana e prokurorit të shtetit, respektivisht lidhur me nenin 248 par. 2 të KPRK-së, gjyqtari i vetëm gjykues vlerëson se është kategori tjetër e veprës penale, (kapitulli XXI) ku bënë pjesë edhe dhuna në familje, plus kur ti referohemi elementeve objektive të kësaj vepre penale sugjeron të i referohemi ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje Nr.03/L-182, pyetja që lind është: në bazë të cilës dispozitë të shqiptojmë sanksionin penale të akuzuarit nga neni 188, neni 184 apo nenit 248 të KPRK-së. Kjo e fundit vije në shprehje vetëm at'her kur kualifikimi bazë në aktakuzë është vepra penale dhuna në familje siç e përcakton dispozita ligjore nga neni 248 par. 1, 2 dhe 3 të KPRK-së.

Matja dhe shqiptimi i dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar i akuzuari e ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprat penale të kryera, sjelljen e tij korrekte gjatë gjykimit, faktin se i akuzuari ka kërkuar falje publike, se nuk rezulton të jetë i dënuar me parë për ndonjë veprë penale dhe se është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ndërsa sa u përket rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese por se vlerësoi peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, prandaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarit i shqiptoi dënim ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit.

Kërkesa pasurore juridike, shpenzimet procedurale dhe llogaritja e paraburgimit

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-se.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë dhe shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në dënimin e shqiptuar si më lartë i llogaritet edhe koha e qëndrimit në paraburgim të akuzuarit nga data 30.08.2019 deri me datën 27.09.2019.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI PERGJITHSHEM

P.nr.1014/19 e dt.11.10.2019

Asistenti

Muedin Rexhepi

Gjyqtari i vetëm gjykues

Illir Bytyqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit nëpërmjet kësaj Gjykate, kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal.